



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës/

Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Departamenti i Arsimit të Lartë dhe Shkencës si dhe Këshilli Shkencor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore Shkencore dt. 28 mars 2013 (Gazeta zyrtare nr. 11/02 maj 2013) dhe Udhëzimit Administrativ nr. 26/2016 i dt. 22.11.2016 për grante për projekte të vogla shkencore, shpall:

KONKURS

(Për projekte të vogla shkencore)

Me të cilin ftohen institucionet kosovare të shkencës dhe shkencëtarët kosovarë të cilët përkrahen nga ndonjë institucion kërkimor-shkencor, që të konkurrojnë për përfitimin e granteve shkencore në kategorinë e **Projekteve të vogla shkencore** (deri 10.000 euro për projekt, me kohëzgjatje prej 6 deri në 12 muaj).

Projektpropozimi duhet t'u përkasë fushave prioritare shkencore sipas Programit Kombëtar të Shkencës ku përfshihen:

- Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi;
- Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit;
- Kërkimi mjekësor;
- Studime ekonomike dhe sociale;
- Studime gjuhësore, kulturore dhe historike;
- Kërkime ndërdisiplinore për teknologjitë e komunikimit dhe informacionit.

Kushtet e veçanta të aplikimit:

1. Aplikacioni i plotësuar dhe i nënshkruar nga bartësi dhe udhëheqësi i institucionit mbështetës dhe i vulosur;
2. Kandidati duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
3. Letërnjoftimi i aplikuesit (kopja);
4. Bartësi të jetë me doktoraturë;
 - 4.1. Bartësi të jetë i fushës së ngushtë, kurse anëtarët të jenë të fushave të cilat ndërlidhen me objektivat e projektit të propozuar;
5. Bartësi të ketë të botuar në revista të indeksuara në Web of Science apo Scopus të paktën një punim shkencor si autor i parë në tri vitet e fundit apo brenda kësaj periudhe të ketë të botuar së paku një monografi shkencore me ISBN;
6. Çdo projekt duhet të përfshijë të paktën tre hulumtues nga një institucion i vetëm në të cilin janë të punësuar si dhe në rastin e universiteteve të jenë nga e njëjta njësi akademike të cilët janë të punësuar në të njëjtin institucion mbështetës dhe së paku 2 **studentë të masterit ose doktoratës**;
7. Hulumtuesit duhet të kenë marrëdhënie pune të rregullt në atë institucion;
8. Çdo projekt duhet të përfshijë si këshilltarë të jashtëm (*jashtë Kosovës*) një ekspert të huaj të fushës së veçantë të hulumtimit;
9. Shkresë e veçantë nga dekani që projekti nuk është realizuar asnjëherë më parë në asnjë formë;
10. Të drejtë aplikimi kanë të punësuarit në Institucione kërkimore-shkencore të vendit;

11. Deklaratë nën betim nga secili pjesëmarrës/anëtar veç e veç në projekt ku ai/ajo zotohet se do të angazhohet në kryerjen e aktiviteteve të parapara me projekt;
12. CV-të dhe listat e publikimeve të bartësit dhe hulumtuesve të angazhuar në projekt;
13. Projekti i dorëzuar në formë fizike dhe USB / CD.

Aplikim i suksesshëm është çdo aplikim që i plotëson kushtet e parapara me konkurs dhe Udhëzim Administrativ (MASHTI) Nr. 26/2016 për aplikim në projektet e vogla shkencore.

Financimi:

Kohëzgjatja: minimale 6 muaj; maksimale 12 muaj.

Granti mbulon këto shpenzime që lidhen me projektin:

- *Pajisje të posaçme, të reja (pajisje laboratorike, mjete shpenzuese, softverë, libra, etj.),*
- *Vizita afatshkurtra,*
- *Konferenca ku prezentohen rezultatet e projektit përfitues,*
- *Shpenzime udhëtimi dhe akomodimi,*
- *Shpenzime të punës në terren,*
- *Shpenzime për këshilltarët e jashtëm,*
- *Pagesa për studentë të angazhuar në projekt.*

Dorëzimi i dokumenteve:

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në **zyrën numër 4 në arkivën e MASH-it**, ndërsa formulari dhe dokumentacioni shtesë për këtë grant mund të shkarkohen në webfaqen e MASH-it: <https://mash.rks-gov.net/alldocuments/formulari-i-aplikimit-per-projekt-kerkimor-2026/>

Mbishkrimi në zarf duhet të ketë këtë përmbajtje: Aplikimi për projekte të vogla shkencore, së bashku me emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe emrin e institucionit.

Afati për konkurrim në këtë konkurs është nga data **14.05.2026** deri më datën **04.06.2026** në orën **16:00**.

Sqarime shtesë:

- Aplikacioni i pakompletuar ose jashtë afatit kohor nuk do të merret në shqyrtim;
- Aplikacionet do të shqyrtohen nga këshillat e fushave shkencore në aspektin përmbajtësor dhe financiar;
- Këshillat e fushave shkencore para se t'i rekomandojnë projektet për financim, do t'i ftojnë aplikuesit për prezantim të projekteve;
- Këshillat e fushave shkencore i rekomandojnë projektet shkencore për mbështetje
- Këshilli Shkencor i MASH vendos për listën e projekteve fituese;
- Aplikimet do të vlerësohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Veprimtarinë kërkimore-Shkencore nr. 04/L-135 dhe në bazë të kriterëve të vlerësimit sipas UA nr. 26/2016 për aplikim në projektet e vogla shkencore;
- Aplikimet e bartësve dhe anëtarëve të projekteve nga vitet e kaluara, të cilat nuk janë përmbyllur nga MASH nuk do të shqyrtohen fare;
- Udhëheqësi i projektit nuk mund të konkurojë me projekt të ri dhe nuk mund të jetë anëtar i ndonjë projekti tjetër përderisa nuk e ka përmbyllur projektin paraprak;
- Udhëheqësi i projektit mund të jetë bartës i vetëm një projekti dhe njëkohësisht nuk mund të jetë anëtar i ndonjë projekti tjetër;
- Anëtari i një projekti mund të jetë njëkohësisht edhe anëtar i një projekti tjetër;
- Në rastet kur dekani përfshihet në projekt, atëherë projektin e nënshkruan menaxheri i dekanit (Rektori);
- Kompjuterët desktopë apo laptopë nuk konsiderohen si pajisje të posaçme prandaj nuk mbulohen në këtë konkurs.

Njoftimi i aplikuesve:

- Vendimi i përfituesve nga ky konkurs do të publikohet në webfaqen e MASH.